

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI

I KURSIT TË UNIFIKUAR

**“PUNIME KARROCERIE NË
AUTOMJETE”**

Kodi: PK-M-4-20

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2020

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“PUNIME KARROCERIE NË AUTOMJETE”

(PK-M-4-20)

I. Profili profesional i punëtorit të punimeve të karrocerisë në automjete

a) Karakteristikat e punëtorit të punimeve të karrocerisë në automjete

Punëtori i punimeve të karrocerisë në automjete është i aftë të kryejë *detyra profesionale*, si i punësuar në ndërmarrje/servise të ndryshme që kryejnë punime të karrocerive të mjeteve të transportit, mund të vetëpunësohen, ose mund të hapin një biznes të vogël për punime të karrocerive të mjeteve të transportit.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, punëtori i punimeve të karrocerisë në automjete duhet që të zotërojë *njohuri* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë që lidhen me veprimtarinë profesionale si dhe *shprehi* profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të punimeve të karrocerisë të mjeteve të transportit.

Suksesi i punëtorit të punimeve të karrocerisë në automjete është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathhtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e punëtorit të punimeve të karrocerisë në automjete

Profesioni i punëtorit të punimeve të karrocerisë në automjete është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për kryerjen e këtyre punimeve në automjete. Ai mund të punësohet ose vetpunësohet në ndërmarrje/servise dhe biznese që kryejnë veprimtari, në sektorin e punimeve të karrocerive të mjeteve të transportit.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e punëtorit të kualifikaur për punime karrocere në automjete. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimin nëpërmjet punës, një punëtor për punime karrocere në automjete mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si teknik i mesëm. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e inxhinierit të mjeteve të transportit.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit “Punime karrocere në automjete”

Në përfundim të kursit për punime karrocere në automjete, kursantët do të jenë të aftë të:

- Përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin teknik për punime të karrocerive të automjeteve.
- Realizojë organizimin e vendit të punës për punime të karrocerive të automjeteve.
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit të punës gjatë punimeve të karrocerive të automjeteve.
- Përzgjedhin drejt dhe përdorin në mënyre korrekte veglat, pajisjet dhe instrumentet e duhura për kryerjen e punimeve të karrocerisë në automjete.
- Përzgjedhin materialet, elementët dhe aksesorët e duhura për punime të karrocerive të automjeteve.
- Mirëmbajnë veglat, pajisjet, instrumentet dhe makineritë në mjedisin e punës.

- Realizojnë matje dhe kontrolle me përdorimin e instrumentave përkatëse.
- Realizojnë punime të mirëmbajtjes në karrocëritë e automjeteve.
- Realizojnë zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara të karrocërive të automjeteve.
- Realizojnë teknikat e saldimit me ngjitje (saldim me hark elektrik, me gaz, me ngjitje të butë dhe të fortë) të pjesëve të dëmtuara të karrocërisë.
- Realizojnë drejtimin e strukturave të shformuara të brendshme (shasi, dysheme etj.) dhe të jashtme (tavan, dyer, kolona etj.) të automjeteve, me pajisjet përkatëse.
- Realizojnë punime të lysterjes së pjesëve të dëmtuara të karrocërive të automjeteve.
- Realizojnë punime të riparimit të pjesëve shformuara të karrocërive të automjeteve.
- Realizojnë punime të riparimit të aksesorëve të karrocërive të automjeteve.
- Realizojnë punime të riparimit të ndenjësive në karrocëritë e automjeteve.
- Kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për punimet e karrocërive të automjeteve.
- Plotësojnë dokumentacionin teknik dhe financiar për punimet e kryera.
- Zbatojnë standardet e profesionit.
- Komunikojnë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Punime karrocërie në automjete”.

Pjesëmarrësit në Kursin “Punime karrocërie në automjete” duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “Punime karrocërie në automjete”

360 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit “Punime karrocërie në automjete”

| Nr | Titulli i Modullit | Kod i | Kohëzgjatja | Rezultatet Mësimore |
|----|---|--------------|---|---|
| 1 | Hyrje në punimet e karrocërisë në automjete | MK-18-240-20 | 30 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori 20% Praktikë 10% Vlerësime | <ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan veçoritë e punimeve të karrocërisë në automjete. 2. Kursanti përshkruan sistemet kryesore të automjeteve të lehta. 3. Kursanti përshkruan materialet që përdoren në karrocëritë e automjeteve 4. Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet dhe materialet e punimeve në karrocëritë e automjeteve. 5. Kursanti përshkruan mirëmbajtjen dhe riparimin e karrocërisë së automjeteve. 6. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit në punimet e karrocërive të automjeteve. |

| | | | | |
|---|---|--------------|---|---|
| 2 | Zëvendësimi i pjesëve të jashtme të karrocerisë | MK-18-241-20 | 60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime | <ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit zëvendësimin e pjesëve të jashtme të karrocerisë. 2. Kursanti zëvendëson dyert e automjetit. 3. Kursanti zëvendëson kofanon e motorit të automjetit. 4. Kursanti zëvendëson parakolpin dhe maskarinon e automjetit. 5. Kursanti zëvendëson parafangon e përparme të automjetit. |
| 3 | Zëvendësimi i aksesorëve të karrocerisë | MK-18-242-20 | 60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime | <ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit zëvendësimin e aksesorëve të karrocerisë. 2. Kursanti zëvendëson mekanizmin e fshirësit të xhamit të automjetit. 3. Kursanti zëvendëson bravën dhe dorezën e derës së automjetit. 4. Kursanti zëvendëson mekanizmin e komandimit të xhamit të derës së automjetit. 5. Kursanti zëvendëson mekanizmin e pasqyrës anësore të automjetit. |
| 4 | Zëvendësimi i ndenjësive dhe xhamave të automjeteve | MK-18-243-20 | 40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime | <ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit riparimin dhe zëvendësimin e ndenjësive dhe xhamave të automjeteve. 2. Kursanti kryen punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit të ndenjësive të automjeteve. 3. Kursanti kryen zëvendësimin e xhamave të automjeteve. |
| 5 | Saldimi MIG dhe MAG, ngjitja dhe shformimi plastik për punime karrocierie | MK-18-244-20 | 100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime | <ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti kryen punime të thjeshta të karrocierisë me saldimit MIG dhe MAG. 2. Kursanti kryen punime të thjeshta të karrocierisë, me ngjitje. 3. Kursanti kryen punime të thjeshta të karrocierisë, me shformim plastik. |
| 6 | Lyerja e pjesëve të karrocerisë | MK-18-245-20 | 70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime | <ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti parapërgatit lyerjen e pjesëve të karrocerisë. 2. Kursanti lyen pjesët metalike të karrocerisë. 3. Kursanti lyen pjesët plastike të karrocerisë. |

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit “Punime karrocere në automjete”:

1. Moduli “Hyrje në punimet e karrocere në automjete”

| <i>PERSHKRUESI I MODULIT</i> | | |
|--|--|---------------------|
| Titulli dhe kodi | HYRJE NË PUNIMET E KARROCERISË NË AUTOMJETE | MK-18-240-20 |
| Qëllimi i modulit | Një modul që i njeh kursantët me veprimtarinë e punëtorit të punimeve të karrocere në automjete, me veçoritë dhe kërkesat e këtij profesioni, me ndërtimin dhe funksionimin e automjeteve të lehta, me mjedisin, mjetet dhe materialet që përdoren në punimet e karrocere, me dokumentacionin teknik përkatës dhe me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 30 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori; 20% Praktikë; 10% Vlerësime | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit | RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e punimeve të karrocere në automjete. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë legjislacionin në fuqi dhe kodin e punës.- të përshkruajë kërkesat profesionale të punëtorit për punime karrocere në automjete.- të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punëtorit për punime karrocere në automjete.- të tregojë mundësitë e punësimit të punëtorit për punime karrocere në automjete.- të shpjegojë mundësitë e karrierës profesionale të punëtorit për punime karrocere në automjete.- të përshkruajë rregullat e komunikimit në mënyrë etike me eprorët, kolegët dhe klientët.- të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës për punime karrocere në automjete.- të përshkruajë rëndësinë e organizimit të punës, strukturën organizative dhe komunikimin hierarkik në punimet e karrocere në automjete. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">- Pyetje përgjigje me gojë.- Pyetje përgjigje me shkrim. | |

RM 2 Kursanti përshkruan sistemet kryesore të automjeteve të lehta.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të bëjë klasifikimin e mjeteve të transportit.
- të listojë sistemet kryesore të automjeteve të lehta të transportit
- të përshkruajë kornizën (shasinë), karrocërinë dhe llojet e tyre.
- të përshkruajë ndërtimin dhe rolin e elementeve kryesore të karrocërive të automjeteve.
- të përshkruajë rolin dhe llojet e MDB.
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të transmetuesit të fuqisë,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të drejtimit,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të frenimit,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të ecjes,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të varjes,
- të përshkruajë rolin, ndërtimin dhe funksionimin e sistemit elektrik dhe të ndriçimit,

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan materialet që përdoren në karrocëritë e automjeteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të listojë materialet metalike që përdoren në karrocëritë e automjeteve.
- të listojë vetitë kimike, fizike, mekanike dhe teknologjike të materialeve metalike që përdoren në karrocëritë e automjeteve.
- të listojë materialet jometalike që përdoren në karrocëritë e automjeteve.
- të listojë vetitë kimike, fizike, mekanike dhe teknologjike të materialeve jometalike që përdoren në karrocëritë e automjeteve.
- të përshkruajë rëndësinë, klasifikimin dhe përdorimet e materialeve plastike në karrocëritë e automjeteve.
- të listojë vetitë kimike, fizike, mekanike dhe teknologjike të materialeve plastike që përdoren në karrocëritë e automjeteve.
- të përshkruajë rëndësinë, klasifikimin dhe përdorimet e gomës në karrocëritë e automjeteve.
- të listojë vetitë kimike, fizike, mekanike dhe teknologjike

- gomës.
- të përshkruajë rëndësinë, klasifikimin dhe përdorimet e materialeve izoluese në karrocëritë e automjeteve.
 - të përshkruajë rëndësinë, klasifikimin dhe përdorimet e xhamit në automjeteve.
 - të përshkruajë rëndësinë dhe përdorimet e tekstilit me fije qelqi dhe fibrave të karbonit në automjeteve.
 - të përshkruajë përdorimet e materialeve në punimet e karrocërisë së automjeteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti përshkruan mjedisin, mjetet dhe materialet e punimeve në karrocëritë e automjeteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë skemën e organizimit të një servisi për punime karrocërie në automjete.
- të përshkruajë ndërtimin, funksionimin dhe pajisjen e një servisi për punime karrocërie në automjete.
- të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe makineritë që përdor punëtori për punime karrocërie në automjete.
- të përshkruajë procesin teknologjik dhe organizimin e punës në shërbimet e karrocërisë në automjete.
- të përshkruajë veshjen e punës së punëtorit për punime karrocërie në automjete.
- të dallojë dhe përshkruajë instrumentet matëse dhe kontrolluese që përdoren në punimet e karrocërisë.
- të dallojë dhe përshkruajë veglat, pajisjet, makinat dhe instrumentat për riparimin me ngjitje të butë dhe të fortë, llojet dhe përdorimet e tyre.
- të dallojë dhe përshkruajë veglat, pajisjet, makinat dhe instrumentat për riparimin me saldim, llojet dhe përdorimet e tyre.
- të dallojë dhe përshkruajë veglat, pajisjet, makinat dhe instrumentat për riparimin e proceseve të drejtimit të copave të thyera, llojet dhe përdorimet e tyre.
- të dallojë dhe përshkruajë veglat, pajisjet, makinat dhe instrumentat për riparimin me saldim plastik të pjesës së dëmtuar të karrocërisë, llojet dhe përdorimet e tyre.
- të dallojë dhe përshkruajë veglat dhe pajisjet për riparimin me “spoter” (me njolla tërheqje nëpërmjet ngjitjes me pikim), llojet dhe përdorimet e tyre.
- të dallojë dhe përshkruajë veglat dhe pajisjet për riparimin e pjesëve të shformuara nëpërmjet tërheqjes me presa hidraulike.
- të dallojë dhe përshkruajë veglat, pajisjet, makinat dhe instrumentat për riparimin e pjesëve me shformim të karrocërisë/shasi, me anë të pajisjeve speciale, si kalibrat

- (bangot universale të drejtimit të shasisë etj.)
- të dallojë dhe përshkruajë veglat dhe pajisjet për lyerjen/stukimin e pjesëve metalike e plastike të karrocerisë.
 - të dallojë dhe përshkruajë veglat dhe pajisjet për procesin e pjekjes së sipërfaqeve metalike e plastike të lyera.
 - të dallojë dhe përshkruajë materialet që përdoren për punimet e karrocerisë së automjeteve.
 - të interpretojë etiketat e materialeve që përdoren për punimet e karrocerisë së automjeteve.
 - të përshkruajë rregullat e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së mjeditit, mjeteve dhe materialeve për punimet e karrocerisë së automjeteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti përshkruan mirëmbajtjen dhe riparimin e karrocerisë së automjeteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të interpretojë dokumentacionin teknik të automjetit (katallogë, manuale, skema ndërtimi dhe funksionimi).
- të interpretojë parametrat e ndërtimit dhe funksionimit të automjeteve.
- të përshkruajë procedurat e shërbimeve të karrocerisë në mjetet e transportit.
- të përshkruajë teknikat konstruktive dhe ndikimin e formës së automjetit në punimet e riparimit të karrocerisë.
- të shpjegojë përkuljen, deformimin dhe përdredhjen e trupit të automjetit.
- të tregojë dëmtimet dhe parregullsitë kryesore në karrocerinë e automjeteve dhe shkaqet e tyre
- të analizojë sjelljen e automjetit gjatë goditjes dhe mënyrat e shpërndarjes së forcave goditëse në strukturat mbajtëse, shasitë, karroceritë dhe kabinat e automjeteve.
- të listojë llojet dhe mënyrat e lidhjeve dhe bashkimeve të elementeve dhe nyjeve të karrocerisë.
- të klasifikojë veçoritë e shërbimeve e karrocerisë në mjetet e transportit
- të përshkruajë procedurat e kontrollit të parregullsive kryesore të elementëve të karrocerisë.
- të përshkruajë shkaqet dhe pasojat e parregullsive kryesore të elementeve të karrocerisë.
- të përshkruajë procedurat për çmontimin dhe montimin e elementëve të karrocerisë.
- të përshkruajë procedurat për përzgjedhjen e aksesorëve dhe pjesëve të karrocerisë që do të zëvendësohen.
- të përshkruajë teknikat e riparimit të karrocerisë.
- të përshkruajë saldimin dhe ngjitjen, veçoritë dhe përdorimi i tyre në riparimin e pjesëve të karrocerive.

- të realizojë matje dhe kontrole kryesore të elementeve të karrocërisë.
- të përshkruajë përpunimin plastik, veçoritë dhe përdorimin e tij në riparimin e elementeve të karrocërisë.
- të përshkruajë lyerjen dhe luçidimin, veçoritë dhe përdorimin në riparimin e elementeve të karrocërisë.
- të përshkruajë proceset e kontrollit përfundimtar për sipërfaqet e lyera, pjekura dhe luçiduara të karrocërisë.
- të përshkruajë menyrat e riparimit dhe vendosjes së xhamave të automjeteve.
- të përshkruajë mënyrën se si bëhen llogaritje të thjeshta ekonomike të punimeve të karrocërisë (volumi i punës dhe kostot, sasia e materialeve, veglave dhe pajisjeve të punës dhe kostot, çmimi i punimeve etj.).

RM 6 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit në punimet e karrocërive të automjeteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të ruajtjes së personit në punë gjatë punimeve në karrocëritë e automjeteve.
- të përshkruajë burimet e rreziqeve në mjediset e punës;
- të përshkruajë procedurat dhe protokollet standarde të sigurisë sipas rastit të emergjencës (tërmet, zjarr, përmytje etj.);
- të përshkruajë masat e mbrojtjes në vendin ku kryhen punimet të karrocërive të mjeteve të transportit.
- të shpjegojë masat e mbrojtjes nga rryma elektrike.
- të shpjegojë masat e mbrojtjes nga zjarri.
- të shpjegojë masat e mbrojtjes nga zhurmat.
- të shpjegojë masat e ruajtjes së mjedisit.
- të përdorë dhe mirëmbajë kompletin e veshjes së punës (rrobot, këpucët, përparësja e lëkurës, dorezat, maska, syzet, mbrojtësja e zhurmave, litari dhe rrypi special).
- të përdorë dhe mirëmbajë siguresat, tokëzimet, shtrojet e gomës për dysheme për mbrojtjen nga rryma elektrike.
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet për shuarjen e zjarrit.
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet e ventilimit dhe ajrosjes në punimet e karrocërive të mjeteve të transportit.
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet sinjalizuese të rrezikut.
- të mirëmbajë mjedisin e punës gjatë punimeve të karrocërive të mjeteve të transportit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes gjatë përdorimit të mjeteve të mbrojtjes në punë.
- të shpjegojë rëndësinë dhe përmbajtjen e kutisë së ndihmës së parë.
- të përdorë drejt mjetet dhe medikamentet e ndihmës së parë.

- të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e djegieve.
- të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e plagosjeve.
- të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e humbjes së vetëdijes.
- të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e goditjes nga rryma elektrike.
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e shërbimit të automjeteve. Mund të organizohen dhe vizita dhe praktika në mjedise pune (servise) ku kryhen punime në karrocerinë e automjeteve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, për mjedisin, mjetet dhe materialet, si dhe për masat e sigurisë dhe dhënien e ndihmës së parë.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin e servisit për punime në karrocerinë e automjeteve, për marrjen e masave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit dhe dhënien e ndihmës së parë për të dëmtuarit. Atyre duhet ti jepen detyra të ndryshme në lidhje me çështjet që trajtohen në modul. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise të praktikës së punimeve në karrocerinë e automjeteve
 - Kutia e ndihmës së parë.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për punime në karrocerinë e automjeteve të lehta.
 - Automjet mësimor.
 - Pjesë të ndryshme të karrocerisë së automjeteve të lehta.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Medie didaktike (CD, filma, etj.) për konkretizimin e njohurive dhe shprehive
-

2. Moduli “Zëvendësimi i pjesëve të jashtme të karrocërisë”

| <i>PERSHKRUESI I MODULIT</i> | | |
|--|--|---------------------|
| Titulli dhe kodi | ZËVENDËSIMI I PJESËVE TË JASHTME TË KARROCERISË | MK-18-241-20 |
| Qëllimi i modulit | Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurën e punës të zmontim/montimit të pjesëve të jashtme të karrocërisë, si dhe i aftëson ata për të realizuar punime të ndryshme të zëvendësimit të pjesëve kryesore në karrocërinë e automjeteve të lehta, me përdorimin e veglave, pajisjeve dhe makinave të nevojshme. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë përbushur modulën “Hyrye në punimet e karrocërisë në automjete”. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit | <p>RM 1 Kursanti parapërgatit zëvendësimin e pjesëve të jashtme të karrocërisë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë dokumentacionin teknik të automjetit. - të evidentojë të dhënat për karrocërinë e automjetit. - të përshkruajë pjesët e jashtme të karrocërisë dhe aksesoret që përdoren. - të përshkruajë procesin teknologjik për zëvendësimin e pjesëve të jashtme të karrocërisë. - të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e pjesëve të jashtme të karrocërisë. - të përshkruajë veglat dhe pajisjet e duhura dhe përdorimin e tyre. - të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin të pjesëve të jashtme të karrocërisë. - të përgatisë preventivin e materialeve dhe aksesoreve të nevojshëm - të llogarisë përbërësit e kostos dhe koston e plotë për materialet, aksesoret, punën dhe faktorët e tjerë. - të llogarisë në mënyrë të përafërt çmimin, të ardhurat dhe fitimin. - të demonstrojë si plotësohet dokumentacioni teknik dhe financiar për punën e kryer. - të kërkojë në katalogje dhe internet për ofertat e materialeve dhe aksesoreve të nevojshëm. - të përzgjedhë materialet dhe aksesoret e nevojshëm. - të demonstrojë si porositëm materialet dhe aksesoret e nevojshëm për punimet në karrocërinë e automjetit. - të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe makinat që nevojiten për | |

-
- çmontim/montim.
- të realizojë provën e funksionimit të pjesëve të zëvendësuara të karrocërisë.
 - të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për zëvendësimin e pjesëve të jashtme të karrocërisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë dhe shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti zëvendëson dyert e automjetit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dokumentacionin teknik të automjetit, të dyerve anësore dhe të derës së bagazhit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e derës anësore ose derës së bagazhit të automjetit.
- të përzgjedhë derën që do të zëvendësojë derën e dëmtuar.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e derës.
- të zmontojë panelin e brendshëm të derës së dëmtuar të automjetit.
- të shkëputë lidhjet elektrike, mekanike, hidraulike ose pneumatike të derës së dëmtuar të automjetit.
- të lirojë bulonat e menteshave të derës që do të zëvendësohet.
- të zmontojë kapje të tjera të derës me kornizën e derës.
- të heqë derën e dëmtuar.
- të pozicionojë dhe të montojë menteshat e derës zëvendësuese.
- të montojë kapjet e tjera të derës zëvendësuese me kornizën e derës.
- të realizojë regjistrimin e pozicionit të përshtatshëm të derës zëvendësuese.
- të rivendosë lidhjet elektrike, mekanike, hidraulike ose pneumatike të derës së montuar me automjetin.
- të montojë panelin e brendshëm të derës së montuar.
- të realizojë provat e funksionimit të derës së montuar.
- të realizojë pastrimet e nevojshme dhe të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të derës anësore ose tderës së bagazhit të automjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti zëvendëson kofanon e motorit të automjetit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të automjetit dhe të kofanos së motorit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e kofanos së dëmtuar të motorit të automjetit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt kofanon e motorit të automjetit për zëvendësim.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e kofanos së motorit.
- të shkëputë lidhjet elektrike ose mekanike (nëse ka) të kofanos së dëmtuar, me automjetin.
- të lirojë bulonat e menteshave të kofanos së motorit, që do të zëvendësohet.
- të heqë kofanon e dëmtuar të motorit.
- të pozicionojë dhe të montojë menteshat e kofanos zëvendësuese.
- të realizojë regjistrimin e pozicionit të përshtatshëm të kofanos zëvendësuese.
- të rivendosë lidhjet elektrike ose mekanike të kofanos zëvendësuese, me automjetin.
- të realizojë provat e funksionimit të kofanos së montuar.
- të realizojë pastrimet e nevojshme dhe të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknike të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të kofanos së motorit të automjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti zëvendëson parakolpin dhe maskarinon e automjetit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të pjesës së përparme të automjetit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e parakolpit dhe maskarinon së dëmtuar të automjetit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt parakolpin dhe maskarinon e automjetit për zëvendësim.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e parakolpit dhe maskarinon së automjetit.
- të lirojë vidat dhe bolonat që fiksojnë maskarinon e dëmtuar në pjesën e përparme të automjetit.
- të heqë maskarinon e dëmtuar të automjetit.
- të lirojë bulonat që fiksojnë parakolpin me shasinë e

- automjetit.
- të heqë parakolpin e dëmtuar të automjetit.
- të pozicionojë parakolpin zëvendësues në shasinë e automjetit.
- të montojë me bulona parakolpin zëvendësues të automjetit.
- të pozicionojë maskarinon zëvendësuese në pjesën e përparme të automjetit.
- të shtrëngojë vidat dhe bolonat që fiksojnë maskarinon zëvendësuese në pjesën e përparme të automjetit.
- të kontrollojë fiksimin e parakolpit dhe maskarinos, të montuara.
- të realizojë pastrimet e nevojshme dhe të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknike të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të parakolpit dhe maskarinos së automjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 5 Kursanti zëvendëson parafangon e përparme të automjetit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të pjesës së përparme të automjetit.
- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e parafangos së përparme, të dëmtuar, të automjetit.
- të përzgjedhë veglat dhe pajisjet e duhura të punës.
- të përzgjedhë drejt parafangon e përparme të automjetit për zëvendësim.
- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e parafangos së përparme.
- të zmontojë dhe të heqë rrotën në krahun e parafangos që do të zëvendësohet (nëse është e nevojshme).
- të zmontojë dhe të heqë elementet e montuar në parafangon e përparme (p.sh., antenën e radios).
- të lirojë vidat dhe bolonat që fiksojnë parafangon e përparme me shasinë dhe pjesët e tjera të karrocërisë së automjetit.
- të heqë parafangon e përparme të dëmtuar të automjetit.
- të pozicionojë parafangon e përparme zëvendësuese në vendin ku do të montohet.
- të vendosë dhe të shtrëngojë vidat dhe bolonat që fiksojnë parafangon e përparme zëvendësuese me shasinë dhe pjesët e tjera të karrocërisë së automjetit.
- të kontrollojë fiksimin e parafangos së përparme të montuar.
- të realizojë pastrimet e nevojshme dhe të tregojë kujdesin

e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknike të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të parafangove të përparme të automjeteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punimeve të karrocërisë në automjete. Mund të organizohen dhe vizita dhe praktika në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të zëvendësimit të pjesëve të jashtme në karrocërinë e automjeteve.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të zëvendësimit të pjesëve të jashtme në karrocërinë e automjeteve.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari praktike të zëvendësimit të dyerve anësore, derës së bagazhit, kofanos së motorit, parafangove të përparme, parakolpeve dhe maskarinove në karrocërinë e automjeteve, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Instruktori duhet të kërkojë zbatimin me përpikmëri nga kursantët të standardeve të profesionit si dhe rregullave të mbrojtjes në punë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, theksi duhet të jetë te kontrolli i aftësive praktike që ata fitojnë gjatë zbatimit të modulit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedisë të praktikës së zëvendësimit në karrocërinë e automjeteve të lehta.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për zëvendësimin e pjesëve të jashtme në karrocërinë e automjeteve të lehta.
 - Automjet mësues.
 - Pjesë të ndryshme të karrocërisë së automjeteve të lehta.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Medie didaktike (CD, filma, etj.) për konkretizimin e njohurive dhe shprehive.
-

3. Moduli “Zëvendësimi i aksesorëve të karrocërisë”

| <i>PERSHKRUESI I MODULIT</i> | | |
|--|--|---------------------|
| Titulli dhe kodi | ZËVENDËSIMI I AKSESORËVE TË KARROCERISË | MK-18-242-20 |
| Qëllimi i modulit | Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurën e punës për zëvendësimin e aksesorëve të ndryshëm të karrocërive, si dhe i aftëson ata për të realizuar këto punime me përdorimin e veglave, pajisjeve dhe makinave të nevojshme. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë përbushur modulën “Hyrje në punimet e karrocërisë në automjete”. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit | <p>RM 1 Kursanti parapërgatit zëvendësimin e aksesorëve të karrocërisë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë dokumentacionin teknik të automjetit. - të analizojë dokumentacionin teknik të aksesorëve të karrocërive të automjeteve. - të përshkruajë llojet e aksesorëve të karrocërive të automjeteve. - të përshkruajë veçoritë konstruktive të aksesorëve të karrocërive. - të përshkruajë procesin teknologjik për zëvendësimin e aksesorëve të karrocërive. - të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e aksesorëve të karrocërive. - të përshkruajë veglat dhe pajisjet e duhura dhe përdorimin e tyre. - të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për zëvendësimin e aksesorëve të karrocërive. - të përzgjedhë materialet dhe aksesorët e nevojshëm. - të përgatisë preventivin e materialeve dhe aksesorëve të nevojshëm. - të llogarisë në mënyrë të përafërt përbërësit e kostos dhe koston e plotë. - të llogarisë në mënyrë të përafërt çmimin, të ardhurat dhe fitimin. - të demonstrojë plotësimin e dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer - të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe makinat që nevojiten për zëvendësimin e aksesorëve të karrocërive. - të përshkruajë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së | |

mjedisit gjatë punimeve për zëvendësimin e aksesorëve të karrocereve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë dhe shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti zëvendëson mekanizmin e fshirësit të xhamit të automjetit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të mekanizmave të fshirëseve të xhamave (të përparmë dhe të pasëm) të automjeteve.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese të mekanizmave të fshirëseve të xhamave.
- të bëjë kontrollin e funksionimit dhe përcaktimin e parregullsive në mekanizmin e fshirësit të xhamit.
- të bëjë zmontimin e mekanizmit të fshirësit të xhamit.
- të zmontojë pjesët e mekanizmit të fshirësit të xhamit.
- të bëjë kontrollin, matjen dhe përcaktimin e parregullsive të pjesëve të mekanizmit të fshirësit të xhamit.
- të përcaktojë hapat e duhura zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara të mekanizmit të fshirësit të xhamit.
- të përzgjedhë pjesët që do të zëvendësojnë pjesët e dëmtuara të mekanizmit.
- të bëjë montimin e pjesëve zëvendësuese të mekanizmit të fshirësit të xhamit.
- të bëjë montimin e mekanizmit të riparuar të fshirësit të xhamit.
- të bëjë kontrollin e funksionimit të mekanizmit të fshirësit të xhamit, të montuar.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të mekanizmit të fshirësit të xhamit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë dhe shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti zëvendëson bravën dhe dorezën e derës së automjetit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të dyerve të automjeteve.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese të bravës dhe dorezës së derës.
- të realizojë kontrollin e funksionimit dhe përcaktimin e parregullsive të bravës dhe dorezës.

- të realizojë zmontimin e pjesëve që pengojnë heqjen e panelit të brendshëm të derës.
- të realizojë zmontimin dhe heqjen e panelit të brendshëm të derës
- të realizojë zmontimin e pjesëve të dorezës së derës dhe të bravës së derës
- të realizojë kontrollin, matjen dhe përcaktimin e parregullsive të pjesëve të bravës dhe dorezës së derës.
- të përcaktojë hapat e duhura për zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara të bravës dhe dorezës së derës.
- të përzgjedhë pjesët e bravës dhe dorezës që do të zëvendësojnë pjesët e dëmtuara.
- të realizojë montimin e pjesëve të bravës së derës dhe të dorezës së derës.
- të bëjë montimin e panelit të brendshëm të derës.
- të realizojë montimin e pjesëve të tjera të panelit të brendshëm të derës.
- të realizojë kontrollin e funksionimit të bravës dhe dorezës së derës, të riparuar.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të bravave dhe dorezave të dyerve

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti zëvendëson mekanizmin e komandimit të xhamit të derës së automjetit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të dyerve të mjeteve të transportit.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese të mekanizmit të komandimit të xhamit të derës.
- të kontrollojë funksionimin dhe të përcaktojë parregullsitë e mekanizmit të komandimit të xhamit të derës.
- të bëjë zmontimin e pjesëve që pengojnë heqjen e panelit të brendshëm të derës.
- të bëjë zmontimin dhe heqjen e panelit të brendshëm të derës.
- të ulë xhamin në pozicion të përshtatshëm dhe të zmontojë mbajtësen e xhamit me rrëshqitësin e mekanizmit.
- të bëjë zmontimin e mbajtëseve dhe të mekanizmit të komandimit të xhamit të derës.
- të bëjë zmontimin e pjesëve të mekanizmit të komandimit të xhamit.
- të bëjë kontrollin, matjen dhe përcaktimin e parregullsive të pjesëve të mekanizmit të komandimit të xhamit.

- të përcaktojë hapat për riparimin/zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara të mekanizmit të komandimit të xhamave.
- të përzgjedhë pjesët që do të zëvendësojnë pjesët e dëmtuara të mekanizmit.
- të bëjë montimin e pjesëve zëvendësuese të mekanizmit të komandimit të xhamave.
- të bëjë montimin e mbajtëseve dhe të mekanizmit të komandimit të xhamit të derës.
- të bëjë montimin e mbajtëses së xhamit me rrëshqitësin dhe me xhamin.
- të bëjë montimin e panelit të brendshëm të derës.
- të bëjë montimin e pjesëve të tjera të panelit të brendshëm të derës.
- të bëjë kontrollin e funksionimit të mekanizmit të riparuar të komandimit të xhamit.
- të bëjë pastrimet e nevojshme dhe të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të mekanizmave të komandimit të xhamave të dymëve të automjeteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti zëvendëson mekanizmin e pasqyrës anësore të automjetit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të mekanizmave të pasqyrave të automjeteve.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese të mekanizmit të pasqyrës anësore.
- të bëjë kontrollin e funksionimit dhe përcaktimin e parregullsive të funksionimit të mekanizmit të pasqyrës anësore.
- të bëjë zmontimin dhe heqjen e panelit të plotë të pasqyrës anësore (në rastin e dëmtimit të plotë).
- të bëjë montimin e panelit zëvendësues të pasqyrës anësore.
- të bëjë zmontimin e kapakëve të panelit të pasqyrës anësore.
- të bëjë kontrollin dhe përcaktimin e parregullsive në pjesët e brendshme të mekanizmit të pasqyrës anësore.
- të përzgjedhë pjesët që do të zëvendësojnë pjesët e dëmtuara.
- të zëvendësojë pasqyrën e dëmtuar.
- të zëvendësojë pjesët e dëmtuara të mekanizmit (elektrik ose mekanik) për kapjen dhe lëvizjen e pasqyrës anësore.
- të zëvendësojë kapakët e dëmtuar të panelit të pasqyrës anësore.

- të bëjë kontrollin e funksionimit të mekanizmit të pasqyrës anësore të zëvendësuar.
- të bëjë pastrimet e nevojshme dhe të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të zëvendësimit të mekanizmave të pasyrave anësore të automjeteve.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punimeve të karrocierisë së automjeteve. Mund të organizohen dhe vizita dhe praktika në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të zëvendësimit të riparimit të aksesorëve kryesorë të karrocierive të automjeteve.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të kontrollit dhe zëvendësimit të aksesorëve të karrocierive të automjeteve.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari praktike për kryerjen e punimeve të kontrollit dhe zëvendësimit të aksesorëve të karrocierive të automjeteve, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Instruktori duhet të kërkojë zbatimin me përpikmëri nga kursantët të standardeve të profesionit si dhe rregullave të mbrojtjes në punë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, theksi duhet të jetë te kontrolli i aftësive praktike që ata fitojnë gjatë realizimit të proceseve të punës për riparimin e aksesorëve të karrocierive.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Repart i punimeve për riparimin e aksesorëve të karrocierive të automjeteve (reparte të qendrës ose servise reale).
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matjen, kontrollin dhe zëvendësimin e aksesorëve të karrocierive të automjeteve.
 - Automjet mësimor.
 - Pjesë këmbimi të aksesorëve të karrocierive të automjeteve.
 - Mekanizma të fshirjes së xhamave, brava dhe doreza të dymve, mekanizma të komandimit të xhamave, mekanizma të pasqyrave
 - Kataloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Medie didaktike (CD, filma, etj.) për konkretizimin e njohurive dhe shprehive.
-

4. Moduli “Zëvendësimi i ndenjësive dhe xhamave të automjeteve”

| <i>PERSHKRUESI I MODULIT</i> | | |
|--|--|---------------------|
| Titulli dhe kodi | ZËVENDËSIMI I NDENJËSEVE DHE XHAMAVE TË AUTOMJETEVE | MK-18-243-20 |
| Qëllimi i modulit | Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurën e punës për të realizuar punime të zmontimit, të riparimit dhe të montimit të ndenjësive dhe xhamave të automjeteve, si dhe i aftëson ata për të realizuar këto punime me përdorimin e veglave, pajisjeve dhe makinave të nevojshme. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë përbushur modulën “Hyrje në punimet e karrocërisë në automjete”. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit | RM 1 Kursanti parapërgatit riparimin dhe zëvendësimin e ndenjësive dhe xhamave të automjeteve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë llojet e ndenjësive të automjeteve dhe veçoritë konstruktive të tyre.- të përshkruajë llojet e xhamave të automjeteve, dhe veçoritë konstruktive të tyre.- të përshkruajë pjesët e ndenjësive të automjeteve dhe aksesoret që përdoren.- të përshkruajë e aksesoret që përdoren për xhamat.- të përshkruajë procesin teknologjik për zëvendësimin e xhamave të automjeteve.- të përshkruajë procesin teknologjik për riparimin/ zëvendësimin e ndenjësive të automjeteve.- të analizojë dokumentacionin teknik të automjetit.- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për riparimin/ zëvendësimin të ndenjësive të automjeteve.- të përcaktojë rradhën e duhur të punës për zëvendësimin e xhamave të automjeteve.- të përshkruajë veglat dhe pajisjet e duhura dhe përdorimin e tyre.- të përgatitë automjetin dhe vendin e punës për riparimin/ zëvendësimin e ndenjësive dhe xhamave të automjeteve.- të përgatisë preventivin e materialeve dhe aksesoreve të nevojshëm.- të llogarisë në mënyrë të përafërt përbërësit e kostos dhe koston e plotë.- të llogarisë në mënyrë të përafërt çmimin, të ardhurat dhe fitimin. | |

- të tregojë si plotësohet dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer.
- të përzgjedhë materialet dhe aksesorët e nevojshëm.
- të përzgjedhë veglat, pajisjevet dhe makinat që nevojiten për riparimin/zëvendësimin e ndenjësive dhe xhamave të automjeteve.
- të përshkruajë rregullat e sigurisë në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për riparimin/zëvendësimin e ndenjësive dhe xhamave të automjeteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë dhe shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti kryen punime të thjeshta të riparimit dhe zëvendësimit të ndenjësive të automjetit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë katalogun e karrocërisë dhe mënyrën e vendosjes së ndenjësive.
- të përzgjedhë drejt instrumentat matës dhe kontrollues.
- të përzgjedh drejt veglat dhe pajisjet e nevojshme për zëvendësimin e ndenjësive.
- të përcaktojë procesin teknologjik të punimeve që do të kryhen.
- të realizojë procesin e zmontimit të ndenjësive nga dyshemeja e mjetit.
- të realizojë zmontimin e ndenjësive në pjesët përbërëse.
- të realizojë kontrollin dhe seleksionimin e pjesëve të konsumuara dhe të difektuara të ndenjësive.
- të analizojë gjendjen e pjesëve dëmtuara të ndenjësive.
- të përcaktojë pjesët që nuk mund të riparohen dhe duhet të zëvendësohen.
- të përcaktojë mënyrën e duhur të riparimit të pjesëve të ndenjësive që mund të riparohen.
- të përzgjedh drejt veglat dhe pajisjet e nevojshme që duhen për procesin e riparimit.
- të realizojë proceset e riparimit me metoda mekanike të pjesëve të ndenjësive që mund të riparohen.
- të realizojë lyerjen e pjesëve të riparuar mekanikisht.
- të realizojë kontrollin e cilësisë së riparimit të ndenjësive.
- të përcaktojë drejt rradhën e montimit të ndenjësive.
- të përzgjedhë drejt veglat dhe pajisjet e nevojshme për montim.
- të përzgjedhë materialin lubrifikues.
- të kryejë procesin e montimit të pjesëve të ndenjësive.
- të kryejë procesin e montimit të tërësisë së ndenjësive.
- të kryejë procesin e grastimit të çifteve kinematike.
- të kryejë montimin e ndenjësive në dyshemenë e automjetit.
- të bëjë kontrollin përfundimtar të montimit dhe funksionimit të ndenjësive.

- të bëjë pastrimet e nevojshme dhe të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknike të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të riparimit/zëvendësimit të ndenjësive të automjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti kryen zëvendësimin e xhamave të automjeteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të automjetit.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese të xhamave.

Në xhamin e përparmë:

- të realizojë kontrollin e xhamit të përparmë (të palëvizshëm) dhe të përcaktojë parregullsitë.
- të përzgjedhë xhamin e përparmë dhe gominën për zëvendësim.
- të përzgjedhë materialin e duhur ngjitës.
- të realizojë pastrimin e xhamit të përzgjedhur.
- të realizojë heqjen e krahëve të fshirësive të xhamit dhe mbrojtësen plastike.
- të realizojë prerjen dhe heqjen pjesës së jashtme të gominës së xhamit.
- të realizojë prerjen, me pajisje prerëse me tel, të lidhjes së gominës me xhamin, në të gjithë perimetrin përkatës.
- të realizojë heqjen e xhamit nga gomina e mbetur në kornizë.
- të realizojë heqjen e pjesës së mbetur të gominës nga korniza e xhamit.
- të realizojë pastrimin e kornizës së xhamit nga mbetjet e gominës dhe të ngjitësit.
- të realizojë vendosjen e gominës së re në xhamin e ri.
- të realizojë pastrimin me solucion të gominës, të xhamit dhe të kornizës së xhamit.
- të realizojë lyerjen me material e duhur ngjitës (silikon) të gominës dhe të pjesës së xhamit pa gominë.
- të realizojë vendosjen e xhamit në pozicionin e duhur në kornizë.
- të realizojë fiksimin paraprak të xhamit me shirita ngjitës.
- të vendosë mbrojtësen plastike dhe të montojë krahët e fshirësive të xhamit.
- të vendosë pasqyrën në xhamin e përparmë.
- të realizojë shiritat ngjitës.

- të realizojë kontrollin përfundimtar të montimit të xhamit të përparmë.

Në xhamat e pasëm dhe anësorë:

- të realizojë kontrollin e xhamave të pasëm dhe anësorë, të palëvizshëm, si dhe të përcaktojë parregullsitë.
- të përzgjedhë xhamin, së bashku me gominën përkatëse, të duhura për zëvendësim.
- të bëjë pastrimin e xhamit të përzgjedhur.
- të shkëputë lidhje elektrike (nëse ka) nga xhami i dëmtuar.
- të realizojë lirimimin e vidave shtrënguese të fashetave mbajtëse të xhamit të dëmtuar.
- të realizojë heqjen e xhamit të dëmtuar.
- të realizojë pastrimin e kornizës së xhamit nga mbetjet e xhamit të dëmtuar.
- të realizojë vendosjen e xhamit të ri (së bashku me gominën) në kornizën përkatëse.
- të realizojë shtërngimin e vidave të fashetave mbajtëse të xhamit.
- të rivendosë lidhjet elektrike (nëse ka) në xhamin e montuar.
- të realizojë kontrollin përfundimtar të montimit të xhamit të pasëm ose anësor, të palëvizshëm.

Në xhamat e lëvizshëm të dyerve:

- të realizojë kontrollin e xhamave të lëvizshëm të dyerve dhe përcaktimin e parregullsive.
- të realizojë zmontimin e pjesëve që pengojnë heqjen e panelit të brendshëm të derës.
- të realizojë zmontimin dhe heqjen e panelit të brendshëm të derës.
- të realizojë pastrimin nga pjesët e xhamave (nëse xhami është thyer).
- të ulë në pozicion të përshtatshëm mbajtësen e xhamit dhe të heqë pjesët e mbetura të xhamit nga mbajtësja.
- të realizojë heqjen e gominës së poshtme të dritares për të lehtësuar futjen e xhamit të ri.
- të përzgjedhë xhamin e duhur për zëvendësim.
- të realizojë pastrimin e xhamit të përzgjedhur.
- të realizojë futjen e xhamit të ri në gominat e dritares së derës.
- të bëjë montimin e xhamit të ri në mbajtësen përkatëse.
- të realizojë provën paraprake të rrëshqitjes së xhamit të montuar në mbajtëse.
- të realizojë montimin e panelit të brendshëm të derës.
- të vendosë gominën e poshtme të dritares.
- të realizojë montimin e pjesëve të tjera të hequra nga paneli i brendshëm i derës.
- të realizojë kontrollin e funksionimit të xhamit të lëvizshëm të zëvendësuar të derës.
- të realizojë pastrimet e nevojshmetë dhe të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.

- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknike të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve të riparimit/zëvendësimit të xhamave të automjetit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punimeve karrocierie në automjete ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të zëvendësimit të xhamave të automjeteve dhe procedurave të punimeve kryesore të procesit të zmontimit, riparimit dhe montimit të ndenjësive të automjeteve.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve të zmontimit, riparimit dhe montimit të ndenjësive dhe të teknikave dhe procedurave të zëvendësimit të xhamave të automjeteve.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari praktike për kryerjen e punimeve të zmontimit, riparimit dhe montimit të ndenjësive dhe punimeve të kontrollit dhe zëvendësimit të xhamave të ndryshëm të automjeteve, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, theksi duhet të jetë te kontrolli i aftësive praktike që ata fitojnë gjatë realizimit të proceseve të punës të zmontimit, të riparimit dhe të montimit të ndenjësive të ndryshme dhe punime të thjeshta të riparimit/ zëvendësimit të xhamave të automjeteve.
- Instruktori duhet të kërkojë zbatimin me përpikmëri nga kursantët të standardeve të profesionit si dhe rregullave të mbrojtjes në punë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës për zëvendësimin e xhamave të automjeteve.
 - Mjedise të praktikës të përshtatshme për kryerjen e punimeve mekanike të zmontim-montimit dhe riparimit të ndenjësive.
 - Ndenjëse të llojeve të ndryshme.
 - Pjesë të ndryshme të ndenjësive të llojeve të ndryshme.
 - Komplet i veglave dhe pajisjeve nevojshme për zmontimin, riparimin dhe montimin e ndenjësive
 - Instrumente për matjen dhe kontrollin e gjëndjes së ndenjësive.
-

-
- Materialet e nevojshme për të realizuar procesin e riparimit të ndenjësive.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për kontrollin dhe zëvendësimin e xhamave të mjeteve të transportit.
 - Automjete mësimore.
 - Xhama të ndryshëm (të përparmë, të pasëm, anësorë, të lëvizshëm) të mjeteve të transportit.
 - Gomina të xhamave të mjeteve të transportit.
 - Ngjitësa të xhamave dhe gominave.
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Medie didaktike (CD, filma, etj.) për konkretizimin e njohurive dhe shprehive.
-

5. Moduli “Saldimi MIG dhe MAG, ngjitja dhe shformimi plastik për punime karrocierie”

PERSHKRUESI I MODULIT

| | | |
|--|--|---------------------|
| Titulli dhe kodi | SALDIMI MIG DHE MAG, NGJITJA DHE SHFORMIMI PLASTIK PËR PUNIME KARROCERIE | MK-18-244-20 |
| Qëllimi i modulit | Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe procedurën e punës për saldimit me MIG dhe MAG të pjesëve të dëmtuara, për riparimin e pjesëve metalike dhe plastike me anë të ngjitjeve të buta dhe të forta, me saldimit plastik dhe riparuar me shformim pjesë të ndryshme të shformuara të karrocierive, si dhe i aftëson ata për të kryer këto punime me përdorimin e veglave, pajisjeve dhe makinave të nevojshme. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 100 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime | |
| Niveli i parapëlqyer për praninë | Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë përmbyshur modulën “Hyrje në punimet e karrocierisë në automjete”. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit | <p>RM 1 Kursanti kryen punime të thjeshta të karrocierisë me saldimit MIG dhe MAG.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë dokumentacionin teknik të karrocierisë. - të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese. - të realizojë kontrollin e pjesës së dëmtuar të karrocierisë dhe të përcaktojë shkallën e dëmtimit. - të zmontojë pjesën e dëmtuar të karrocierisë (nëse është e nevojshme). - të përcaktojë drejt llojin e saldimit special MIG (Metal Inert Gas) dhe MAG (Metal Active Gas) që do të përdoret. - të përzgjedhë aparatën e duhur për saldimit special përkatës. - të përcaktojë hapat e duhura për riparimin me saldimit special të pjesës së dëmtuar të karrocierisë. - të përzgjedhë veglat e duhura për të kryer procesin e riparimit me saldimit special të përzgjedhur. - të përzgjedhë materialin e duhur mbushës për saldimit special të përzgjedhur. - të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse për saldimit special. - të parapërgatisë pjesët e karrocierisë që do riparohen me saldime speciale (drejtimin e copave të thyera dhe të shformuara, përgatitja dhe pastrimi i buzëve, përgatitja e zonave të plasaritura). - të përgatitë bangon dhe të vendosë pjesën në bango (nëse | |

-
- saldimi do të kryhet në bango).
 - të përgatitë për punë aparatit e përzgjedhur për saldimit special (MIG ose MAG).
 - të vendosë regjimin e saldimit special përkatës.
 - të zbatojë teknikat e saldimit special MIG të pjesëve të karrocerisë.
 - të zbatojë teknikat e saldimit special MAG të pjesëve të karrocerisë.
 - të bëjë punimin përfundimtar të tegelit të saldimit special të kryer.
 - të bëjë matjen dhe kontrollin e cilësisë së saldimit special të kryer.
 - të bëjë heqjen e pjesës së riparuar nga bangoja (kur saldimit special kryhet në bango).
 - të bëjë montimin e pjesës së riparuar në karroceri (kur është çmontuar më parë).
 - të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
 - të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer.
 - të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë saldimit special të pjesëve të dëmtuara të karrocerisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti kryen punime të thjeshta të karrocerisë, me ngjitje.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të karrocerisë.
- të përzgjedhë instrumentat dhe aparatet matëse dhe kontrolluese të duhura.
- të bëjë kontrollin e pjesës së dëmtuar të karrocerisë dhe të përcaktojë shkallën e dëmtimit.
- të realizojë zmontimin e pjesës (detalit) metalike të dëmtuar të karrocerisë (nëse është e nevojshme).

Punime të thjeshta riparimi me ngjitje të fortë:

- të përcaktojë hapat e duhura për riparimin me ngjitje të fortë të pjesës së dëmtuar.
- të përzgjedhë pajisjen e duhur për ngjitjen e fortë.
- të përzgjedhë materialet dhe veglat e nevojshme për të kryer procesin e ngjitjes së fortë.
- të realizojë parapërgatitjen e detalit të dëmtuar për ngjitje të fortë.
- të vendosë detalin e dëmtuar në pajisjen shtrënguese (në bango).
- të përgatitë pajisjen për ngjitjen e fortë.

- të përgatitë materialin (bakrin, bronzin etj.) për ngjitjen e fortë.
- të realizojë procesin e ngjitjes së fortë të detalit metalik të karrocerisë.
- të realizojë punimin përfundimtar të pjesës së ngjitur të detalit.
- të realizojë heqjen e detalit të riparuar nga pajisja shtrënguese.
- të realizojë kontrollin e ngjitjes së detalit metalik.
- të realizojë montimin e detalit të riparuar në karroceri.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të karrocerisë me anë të ngjitjes së fortë.

Punime të thjeshta riparimi me anë të ngjitjes me materiale ngjitëse:

- të përcaktojë mënyrën e duhur për riparimin me materiale ngjitëse të pjesës së dëmtuar.
- të përzgjedhë materialet ngjitëse dhe veglat e duhura për të kryer procesin e ngjitjes.
- të lexojë dhe interpretojë drejt udhëzimet për përgatitjen dhe përdorimin e materialeve ngjitëse.
- të bëjë parapërgatitjen mekanike dhe pastrimin e sipërfaqeve të pjesëve që do të ngjiten me materiale ngjitëse.
- të bëjë përgatitjen e materialit ngjitës.
- të bëjë lyerjen ose mbushjen me material ngjitës të sipërfaqeve të pjesëve që do të ngjiten.
- të bëjë bashkimin dhe fiksimin e pjesëve që do të ngjiten në pozicionin e duhur.
- të bëjë punimin përfundimtar të sipërfaqeve të ngjitura, pas ngurtësimit të materialit ngjitës.
- të bëjë kontrollin e ngjitjes së pjesës së dëmtuar të karrocerisë.
- të bëjë montimin (në rast se është zmontuar) të pjesës së riparuar me ngjitje, në karroceri.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të pjesëve të karrocerisë me anë të ngjitjes me materiale ngjitëse.

Punime të thjeshta riparimi me anë të saldimit plastik:

- të përcaktojë hapat e duhura për riparimin me saldimit plastik të pjesës së dëmtuar të karrocerisë.
- të përzgjedhë pajisjen termike dhe materialin mbushës, të duhura për saldimit plastik.
- të përzgjedhë veglat e nevojshme për të kryer procesin e saldimit plastik.
- të bëjë parapërgatitjen mekanike dhe pastrimin e sipërfaqeve të pjesëve plastike.
- të vendosë dhe fiksojë pjesët që do të saldohen në

- pozicionin e duhur.
- të përgatitë pajisjen termike dhe të vendosë parametrat e duhura për saldimitin plastik.
 - të bëjë saldimitin plastik të pjesëve plastike të dëmtuara të karrocerisë.
 - të bëjë punimin përfundimtar të tegelit të saldimitit plastik.
 - të bëjë kontrollin e saldimitit plastik të pjesëve plastike të dëmtuara të karrocerisë.
 - të bëjë montimin (në rast se ishte zmontuar) të pjesës së riparuar në karroceri.
 - të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
 - të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer.
 - të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të pjesëve plastike të karrocerisë me anë të saldimitit plastik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti kryen punime të thjeshta të karrocerisë, me shformim plastik.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë drejt dokumentacionin teknik të karrocerisë.
- të bëjë zmontimin e pjesës së shformuar (parakolpit, parafangos, maskarinos, derës, mbulesës së motorit, mbulesës së bagazhit etj.).
- të përzgjedhë instrumentat e aparatet e duhura matëse dhe kontrolluese.
- të bëjë kontrole dhe matje të sakta për përcaktimin e shkallës së shformimit të pjesës së karrocerisë.
- të përcaktojë hapat e duhura për riparimin me shformim plastik të pjesës së shformuar.
- të përzgjedhë pajisjet dhe veglat e duhura për të kryer riparimin me shformim të pjesës së dëmtuar.
- të bëjë nxehjen paraprake (nëse është e nevojshme) të pjesës, me pajisje termike.
- të bëjë riparimin me shformim plastik të pjesës së dëmtuar, me anë të pajisjeve përkatëse.
- të bëjë kontrollin dhe matjen përfundimtare të pjesës së riparuar me shformim plastik.
- të realizojë montimin në karroceri të pjesës së riparuar me shformim plastik.
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për

punën e kryer.

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit me shformim plastik të pjesëve të karrocerisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punimeve të karrocerisë në automjete ose në mjedise pune (servise) ku kryhen punime të saldimit me MIG dhe MAG, me ngjitje dhe me shformim plastik për riparimin e karrocerisë.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve të saldimit me MIG dhe MAG, me ngjitje dhe me shformim plastik për riparimin e karrocerisë.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari praktike për kryerjen e punimeve të saldimit me MIG dhe MAG, me ngjitje dhe me shformim plastik për riparimin e karrocerisë, fillimisht të mbikqyrur nga instruktori dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës që kryejnë.
- Instruktori duhet të kërkojë zbatimin me përpikmëri nga kursantët të standardeve të profesionit si dhe rregullave të mbrojtjes në punë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, theksi duhet të jetë te kontrolli i aftësive praktike që ata fitojnë gjatë realizimit të proceseve të punës të saldimit me MIG dhe MAG, me ngjitje dhe me shformim plastik për riparimin e karrocerisë së automjeteve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të punimeve karrocerie në automjete ose mjedise pune (servise) ku kryhen punime të saldimit me MIG dhe MAG, me ngjitje dhe me shformim plastik për riparimin e karrocerisë.
 - Automjet mësimor.
 - Aparate për saldime speciale (MIG dhe MAG) dhe pajisjet përkatëse.
 - Materialet e nevojshme për saldime speciale të pjesëve të karrocerive.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, kontrolle dhe saldime speciale.
 - Karroceri të ndryshme të mjeteve të transportit dhe pjesë të ndryshme të karrocerive.
 - Aparate, pajisje dhe vegla për ngjitje të forta dhe të buta dhe për saldime plastik.
 - Materialet e nevojshme për ngjitje të forta dhe të buta dhe për
-

saldim plastik.

- Materiale ngjitëse të ndryshme dhe udhëzuesa të përdorimit të tyre.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për kontrollin, matjen dhe riparimin me shformim të pjesëve të karrocereve të mjeteve të transportit.
 - Pjesë të karrocereve të automjeteve (parakolpo, maskarino, parafango, dyer, mbulesa motori dhe bagazhi).
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Medie didaktike (CD, filma, etj.) për konkretizimin e njohurive dhe shprehive.
-

6. Moduli “Lyera e pjesëve të karrocerisë”

| <i>PERSHKRUESI I MODULIT</i> | | |
|--|--|---------------------|
| Titulli dhe kodi | LYERJA E PJESËVE TË KARROCERISË | MK-18-245-20 |
| Qëllimi i modulit | Një modul që i njuh kursantët me veçoritë dhe procedurën e punës për lyerjen e pjesëve të karrocerive të automjeteve, si dhe i aftëson ata për lyerjen e këtyre pjesëve, me përdorimin e veglave, pajisjeve dhe makinave të nevojshme. | |
| Kohëzgjatja e modulit | 70 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime | |
| Niveli i parapëlqyer për pranim | Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë përmbushur modulën “Hyrje në punimet e karrocerisë në automjete”. | |
| Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit | RM 1 Kursanti parapërgatit lyerjen e pjesëve të karrocerisë. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të analizojë drejt katalogun e karrocerisë.- të përcaktojë pjesët metalike të karrocerisë që do të lyhen.- të zmontojë pjesët metalike që do të lyhen (nëse është e nevojshme).- të përcaktojë hapat e procesit teknologjik për të kryer lyerjen e pjesëve të karrocerisë.- të përcaktojë pjesët e karrocerisë që do të përpunohen paraprakisht mekanikisht.- të përzgjedhë instrumentat e duhura të kontrollit.- të bëjë matjet dhe kontrollet e nevojshme.- të përzgjedhë veglat e nevojshme për të bërë përpunimin paraprak të pjesëve metalike që do të lyhen.- të kryejë punimet mekanike paraprake (sheshimin e sipërfaqeve të shtypura, limimin e buzëve, pastrimin me letër zmerilio).- të përcaktojë llojin e materialit të pjesëve plastike që do të lyhen.- të përcaktojë hapat e procesit teknologjik për të kryer lyerjen e pjesëve plastike të karrocerisë.- të përcaktojë pjesët plastike të karrocerisë që do të përpunohen paraprakisht mekanikisht.- të zmontojë pjesët plastike që do të lyhen (nëse është e nevojshme).- të përzgjedhë veglat e nevojshme për të bërë përpunimin paraprak të pjesëve plastike që do të lyhen.- të kryejë punimet mekanike paraprake të pjesëve plastike (larjen me solvent, tamponimin e gropëzave, pastrimin me letër zmerilio).- të realizojë saktë procesin e stukimit. | |

-
- të realizojë saktë zmerilimin përfundimtar.
 - të realizojë saktë kontrollin e cilësisë së stukimit dhe punimit mekanik përfundimtar.
 - të përzgjedhë vegla dhe pajisjet e duhura për pastrimin kimik.
 - të përzgjedhë materialet dhe solucionet e duhura për pastrimin kimik.
 - të përgatitë enën (vaskën) për pastrimin kimik të pjesëve.
 - të përgatitë solucionin kimik për heqjen e oksideve nga sipërfaqja që do të lyhet.
 - të realizojë zhytjen e pjesës së karrocerisë në enën për heqjen e oksideve.
 - të përgatitë solucionin kimik për heqjen e yndyrnave nga sipërfaqja që do të lyhet.
 - të realizojë zhytjen e pjesës së karrocerisë në enën për heqjen e yndyrnave (në rastin kur boja do të jetë e lëngëshme).
 - të realizojë shplarjen e pjesës së karrocerisë nga mbeturinat e solucionit kimik.
 - të përgatisë preventivin e materialeve dhe aksesorëve të nevojshëm.
 - të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve paraprake për lyerjen e pjesëve metalike dhe plastike të karrocerisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti lyen pjesët metalike të karrocerisë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dhe të kontrollojë sipërfaqet metalike që do të lyhen.
- të përcaktojë mënyrën e duhur të lyerjes së sipërfaqeve metalike të karrocerisë (në dhoma të posaçme apo në vende të caktuara).
- të përzgjedhë materialet e nevojshme për lyerje.
- të përzgjedhë nga katalogu ose të përgatitë bojën me ngrën e duhur për lyerje
- të përzgjedhë dhe përgatitë pajisjen për lyerjen.
- të kryejë lyerjen e sipërfaqes metalike të pjesës së karrocerisë.
- të analizojë lyerjen e sipërfaqeve metalike të karrocerisë.
- të përcaktojë regjimin e duhur të procesit të pjekjes.
- të përgatitë furrën me regjimet e duhura për pjekjen.
- të mbikqyrë proesin e pjekjes në furrë.
- të analizojë procesin e pjekjes së sipërfaqeve metalike të lyera.
- të përzgjedhë veglat e duhura për luçidimin e sipërfaqes.

- të përzgjedhë materialet e nevojshme për luçidim.
- të kryejë luidimin e sipërfaqes metalike të pjesës së karrocerisë
- të analizojë luçidimin e sipërfaqeve metalike të karrocerisë, të lyera dhe të pjekura.
- të bëjë kontrollin përfundimtar të sipërfaqeve metalike të lyera, të pjekura dhe të luçiduara të karrocerisë.
- të montojë pjesët metalike të lyera të karrocerisë (nëse është e nevojshme).
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të lyerjes, pjekjes dhe luçidimit të pjesëve metalike.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti lyen pjesët plastike të karrocerisë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të analizojë dhe të kontrollojë sipërfaqet plastike që do të lyhen.
- të përcaktojë mënyrën e duhur të lyerjes së sipërfaqeve plastike të karrocerisë (në dhoma të posaçme apo në vende të caktuara).
- të përzgjedhë materialet e nevojshme për lyerje.
- të përzgjedhë nga katalogu ose të përgatitë bojën me ngyrën e duhur për lyerje
- të përzgjedhë dhe përgatitë pajisjen për lyerjen e pjesëve plastike të karrocerisë.
- të kryejë lyerjen fillestare të pjesës plastike.
- të kryejë lyerjen e sipërfaqeve plastike të karrocerisë.
- të përcaktojë regjimin e duhur të procesit të pjekjes (tharjes).
- të përgatitë furrën për pjekjen (tharjen).
- të mbikqyrë procesin e pjekjes së sipërfaqeve plastike të lyera.
- të realizojë kontrollin përfundimtar të sipërfaqeve plastike të lyera dhe të pjekura të karrocerisë.
- të montojë pjesët plastike të lyera të karrocerisë (nëse është e nevojshme).
- të tregojë kujdesin e duhur për veglat dhe pajisjet e punës.
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer.
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për punën e kryer.

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë procesit të lyerjes së pjesëve plastike të karrocerisë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e lyerjes së karrocerive ose në reparte të lyerjes të bizneseve lokale.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të teknikave dhe procedurave të punimeve paraprake dhe kryesore të procesit të lyerjes së pjesëve plastike të karrocerisë. Në mungesë të furrës për pjekjen (tharjen) e bojës, mund të kryhen proceset e tjera ose të praktikohet pjekja (tharja) në furra të bizneseve lokale për shërbime të karrocerisë.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari praktike konkrete për kryerjen e punimeve paraprake mekanike, të stukimit, lyerjes dhe pjekjes (tharjes) së sipërfaqeve metalike dhe plastike të karrocerisë, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me tërësinë e proceseve të lyerjes.
- Instruktori duhet të kërkojë zbatimin me përpikmëri nga kursantët të standardeve të profesionit si dhe rregullave të mbrojtjes në punë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve, theksi duhet të jetë te kontrolli i aftësive praktike që ata fitojnë gjatë zbatimit të modulit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Repart të praktikës të përshtatshme për kryerjen e punimeve paraprake dhe të lyerjes së pjesëve plastike të karrocerisë.
 - Pjesë të ndryshme metalike dhe plastike të karrocerisë që mundësojnë realizimin e procesit teknologjik të lyerjes.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, kontrole dhe lyerje të pjesëve metalike dhe plastike.
 - Materialet e nevojshme për të realizuar procesin e lyerjes
 - Furrë për pjekje ose tharje (në pamundësi të furrës me përmasa reale, mund të përdoren dhe furra të vogla për tharjen e detaleve me përmasa të vogla).
 - Formate të dokumentacionit teknik dhe financiar.
 - Katallogë (të karrocerisë dhe bojërave), manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
 - Medie didaktike (CD, filma, etj.) për konkretizimin e njohurive dhe shprehive.
-